



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

RAPORT PËRFUNDIMTAR

**MBI GJETJET DHE KONKLuzionET E MONITORIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DT. 30 QERSHOR 2019**

Tiranë, Gusht 2019



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “*Garantimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme përmes monitorimit të Zgjedhjeve Vendore në Shqipëri – Qershor 2019*”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga Republika Federale Gjermane.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



bashkëpunimi
gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Republikës Federale Gjermane.

Përgatiti:

1. Znj. Ardita Kolmarku, Juriste, KShH

Supervizuan dhe rishikuan raportin:

1. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor i KShH-së
2. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e KShH-së

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”

Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Cel: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është organizatë jofitimprurëse e themeluar më 16 Dhjetor të vitit 1990. Misioni i KShH-së është të kontribuojë për respektimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit të së drejtës, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

Siç dihet, ushtrimi i së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur është një e drejtë themelore e sanksionuar në Kushtetutë. Në këtë vështrim zgjedhjet periodike, KShH i vlerëson si ngjarje të rëndësishme. Kjo është edhe arsyeja që KShH është angazhuar vazhdimisht në monitorimin e tyre prej vitit 1996, duke mos u kufizuar vetëm në procesin e votimit dhe numërimit të votave. Monitorimi ynë ka synuar rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe përgjegjshmërinë e institucioneve kompetente për rëndësinë që ka e drejta kushtetuese për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në një shoqëri demokratike ku duhet të mbizotërojë shteti i së drejtës.

KShH monitoroi Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të dt. 30 Qershor 2019. Për këto zgjedhje, KShH është vënë në lëvizje menjëherë pas Dekretimit të zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës, sepse menjëherë pas kësaj date do të duhej të fillonin përgatitjet për zgjedhjet. Monitorimi i KShH-së u shtri në periudhën parazgjedhore, votimin si dhe numërimin e votave. Ai ishte i pjesshëm për faktin se u mbuluan vetëm 182 Qendra Votimi nga 5417 që ishin gjithsej. U arrit pra të monitorohej vetëm 3.4% të numrit total të qendrave të votimit. Monitorimi i procesit të numërimit u shtri në 12 KZAZ nga 90 të tilla që janë në shkallë vendi (pra në 13.3% të tyre).

KShH akreditoi në KQZ 115 vëzhgues afatgjatë. Për monitorimin e Zgjedhjeve të 30 Qershorit, vëzhguesit e KShH-së u shpërndanë në 9 qytete, përkatësisht në Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë. Edhe pse monitorimi nga vëzhguesit e këtij Komiteti ka qenë i kufizuar, të dhënat e paraqitura në raportet e vëzhguesve tanë mund të shërbejnë në evidentimin e disa çështjeve që duhen patur parasysht në të ardhmen.

Paraprakisht të gjithë vëzhguesit u njohën (u trajnuan) me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së. Gjatë trajnimit, në mënyrë të veçantë u sqarua metodologjia e vëzhgimit lidhur ngushtë kjo me të drejtat dhe detyrat që atyre u garanton ligji, qëndrimet e paanshmërisë dhe pandikueshmërinë që ata duhet të mbanin. KShH falenderon të gjithë vëzhguesit dhe korrespondentët në rrethe, për profesionalizmin, paanshmërinë dhe përkushtimin e tyre. Falenderojmë në mënyrë të veçantë stafin e KShH-së dhe Republikën Federale Gjermane që mbështeti financiarisht realizimin e veprimtarisë për monitorimin e këtij procesi zgjedhor.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

1. Përmbledhje Ekzekutive

1.1 Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, megjithëse me vonesë, u ngrit Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore që kryesohej nga dy bashkëkryetarët e mazhorancës dhe opozitës. Komisioni duhej të angazhohej me shqyrtimin dhe miratimin e Rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, jo vetëm të vitit 2017, por edhe të disa rekomandimeve të tjera që nuk ishin shqyrtuar dhe që i përkisnin Raporteve të viteve 2013 dhe 2015. Vlen të përmendet se nga 75 rekomandime, 25 prej tyre ishin prioritare.

1.2 KShH ka treguar vëmendje të veçantë lidhur me ecurinë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar të Reformës Zgjedhore edhe për faktin se vërehej një ngadalësim i theksuar i punës së tij. Në veprimtaritë e realizuara nga komisioni, deklarohet se po shqyrtoheshin rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, ndërsa në fakt nuk po arrihej asnjë konsensus midis forcave politike të përfaqësuara në këtë komision. Komisioni nuk arriti asnjë rezultat konkret. Mund të themi se veprimtaria e tij dështoi sikurse kishte dështuar edhe veprimtaria e Komisionit të mëparshëm parlamentar për reformën zgjedhore. Ekspertët e caktuar nga Komisioni përgatitën një projekt amendamentesh, por ai nuk u bë objekt diskutimi, sepse deputetët e opozitës, për shkak të mosmarrëveshjeve të natyrës politike fillimisht u larguan nga Kuvendi dhe më pas hoqën dorë nga mandatet e tyre.

1.3 Lidhur me sistemin zgjedhor, mendojmë se kjo çështje kërkon një analizë të thelluar, objektive dhe konsultim të gjerë me qytetarët. Rishikimi i sistemit zgjedhor kërkon paralelisht një reformë ligjore në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të partive politike, forcimin e demokracisë së tyre të brendshme, ndarjen dhe balancimin e kompetencave të kryetarit të partisë për zgjedhjen e kandidaturave që i propozohen elektoratit.

1.4 Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj”, dhe nenin 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, me Dekretin nr.10928, datës 05.11.2018 caktoi datën 30 qershor 2019, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

1.5 Në prag të regjistrimit në KQZ të subjekteve zgjedhore, deputetët e partive opozitare vendosën të heqin dorë nga mandatet e tyre. Zëvendësimi i vendeve vakante të krijuara në Kuvend acaroi më tepër klimën politike. Fill pas kësaj, opozita jashtë parlamentit e konkretizoi qëndrimin e saj dhe deklaroi se nuk mund të merrte pjesë në zgjedhje farsë dhe theksoi se “zgjedhje në datën 30 qershor nuk do të kishte”. Kjo më vonë u shoqërua edhe me thirrjen që ju bë votuesve për të bojkotuar zgjedhjet. Gjatë gjithë kësaj periudhe u zhvilluan disa tubime të organizuara nga partitë opozitare. KShH, bazuar në legjislacionin tonë dhe atë ndërkombëtar ka deklaruar se kushdo gëzon të drejtën për të tubuar, por nisur nga zhvillimet e dhunshme në disa prej protestave, bëri thirrje se ato duhet të ishin paqësore.

1.6 Partitë opozitare (PD dhe aleatët e saj, si dhe LSI-ja) nuk u regjistruan si subjekte zgjedhore. Numri total i kandidatëve për Kryetar Bashkie në këto zgjedhje ishte 97, ndër të



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

cilët vetëm 11 femra. Kjo shifër tregon një pjesëmarrje dhe përfaqësim të ulët, afro 10% të gruas për të kandiduar në nivel kryetar bashkie. Kodi ynë Zgjedhor nuk parashikon kuota gjinore për kandidatët që propozohen për kryetar bashkie nga subjektet zgjedhore por vetëm kuota për anëtarët e Këshillit Bashkiakë.

1.7 Në 31 Bashki konkurroi në garën për Kryetar vetëm 1 kandidat.¹ Mungesa e kandidatëve alternativë si dhe fakti që në legjislacionin tonë nuk parashikohet një minimum votash për tu zgjedhur fitues (fitues shpallet ai kandidat që ka fituar më shumë vota), bëri që në këto Bashki të mos kishte garë.

1.8 Pas caktimit të datës së zgjedhjeve me dekret të Presidentit, KShH monitori me anë të vëzhguesve të tij disa aspekte kryesore të procesit parazgjedhor, të ditës së votimit dhe të monitorimit, të cilat i paraqesim në mënyrë të përmbledhur në vijim:

a. Vëzhguesit e KShH-së konstatuan raste që aksesit i zgjedhësve në listat paraprake të shpallura (ekstraktet e përbërësve zgjedhore) ishte i vështirë, jo vetëm si pasojë e mos vendosjes së listave në vend të përshtatshëm, por edhe pse disa njësi administrative dhe shkolla ku ato ishin vendosur në orët e pasdites nuk ishin të hapura. Gjithashtu, KSHH konstatoi se njësitë të qeverisjes vendore nuk i është alokuar fondi përkatës nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme për njoftimin e zgjedhësve në banesë.

b. Megjithëse fushata zgjedhore sipas Kodit Zgjedhor duhet fillonte me 31 Maj 2019, Partia Socialiste (PS) në disa raste ka zhvilluar aktivitete të natyrës politike para kësaj date. Për këtë KShH ka vënë në dijeni KQZ-në, e cila duhet të ishte më pro-aktive për identifikimin e këtyre rasteve të cilat ishin publike dhe nëse ishte rasti të zbatonte dispozitat sanksionuese të Kodit Zgjedhor.

c. Vëzhguesve të KShH-së i'u janë përcjellë në qytetin e Fierit dhe të Shkodrës, pretendime për shfrytëzimin e administratës publike për qëllime propagandistike zgjedhore si dhe për faktin se punonjësve ju është kërkuar që të votojnë dhe të sigurojnë pjesëmarrjen e një numri të caktuar vëzhguesish nga familjarët e tyre. Këto pretendime janë të padokumentuara.

d. KShH ka monitoruar pjesërisht edhe veprimtarinë e organit më të lartë të administrimit zgjedhor, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). KQZ ka ushtruar funksionin e tij në kushtet e një volumi të madh pune dhe situatë të polarizuar politike. Vakancat e krijuara në përbërjen e tij nuk u plotësuan nga opozita parlamentare. Zhvillimet në KQZ pas Dekretit të Presidentit të Republikës për anulimin e datës 30 Qershor të zgjedhjeve, pozicionuan në qëndrime haptazi të ndryshme kryetarin e KQZ-së nga njëra anë dhe pjesën tjetër të anëtarëve të tij. KShH vlerëson se depolitizimi i plotë i këtij organi në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR do ti vlejë më mirë respektimit dhe garantimit

¹ Këto bashki janë: Kuçovë, Poliçan, Skrapar, Ura Vajgurore, Mat, Krujë, Elbasan, Librazhd, Peqin, Divjakë, Fier, Lushnjë, Patos, Roskovec, Dropull, Gjirokastrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Maliq, Pogradec, Has, Fushë-Arrëz, Pukë, Shkodër, Vau i Dejës, Rrogozhinë, Vorë, Delvinë, Konispol, Himarë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

të standarteve të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në të ardhmen. Gjithashtu, KShH vlerëson se anëtarë të KQZ-së, në momente të vështira të vendimarrjes, të cilat u shoqëruan me kundërshti apo akuza përfaqësues të politike, duhet të kishin shmangur replikat publike individuale, të cilat kishin pjesërisht nuanca të dukshme politike.

e. Pasojat shqetësuese në drejtim të mbarëvajtjes normale dhe administrimit të procesit zgjedhor u ndjenë sidomos pas refuzimit të dy partive më të mëdha opozitare për t'u regjistruar si subjekte zgjedhore. Vakancat në organet administrimit zgjedhor në nivel të dytë apo të tretë, KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve diktuan plotësimin e tyre (jo të plotë) me persona të cilët u referuan se ishin nga shoqëria civile. Në vlerësimin e KShH-së është i diskutueshëm vendimi i KQZ-së nr.127, dt.04.04.2019, i jep disa këtij organi tagra të cilat nuk i janë akorduar në K.Zgjedhor, për të plotësuar vakancat e krijuara në KQV, duke i propozuar KZAZ-së listat e shtetasve që mund të emërohen anëtarë/sekretarë të KQV/GNV.

f. Procesi parazgjedhor është shoqëruar nga incidente të shumta dhe akte të dhunshme të ndërmarra ndaj KZAZ-ve. Në disa raste, vëzhguesit e KShH-së në rrethe raportuan se në këto incidente u përfshinë përfaqësues të opozitës dhe personelit të bashkive opozitare sikurse ishte rasti në Bashkinë Shkodër.

g. Në Bashkitë Elbasan, Durrës, Gjirokastrë dhe Tiranë, vëzhguesit e KShH-së kanë vërejtur prezencën e personave të paautorizuar, në ambientet e brendshme të QV dhe në ambientet e jashtme por brenda perimetrit të godinës ku ishin vendosur këto QV.

h. Gjatë procesit të numërimit të votave, vëzhguesit e KShH-së kanë raportuar se ai u zhvillua në përgjithësi i qetë dhe transparent. Në disa raste ka patur vonesa në fillimin nga puna të grupeve të numërimit, për shkak të ngritjes së tyre me vonesë apo trajnimit të tyre pikërisht në kohën kur ato duhet të fillonin nga puna.

1.9 Nga të dhënat përfundimtare të publikuara nga KQZ, në këto zgjedhje morën pjesë 811,727 zgjedhës ose 22.96% e numrit të përgjithshëm. Në raport me pjesëmarrjen e zgjedhësve në zgjedhjet e mëparshme parlamentare të vitit 2017 konstatohet një rënie prej 23.76% të numrit, ndërkohë në raport me zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015 vërehet se 24.9% me pak zgjedhës i janë drejtuar qendrave të votimit. Në këtë përlllogaritje duhet të mbahet parasysh edhe situata e pazakontë politike në të cilat u zhvilluan këto zgjedhje. KShH vëren se në tërësi, i gjithë ky proces i shoqëruar me një retorikë të ashpër politike, pati shumë pak në vëmendje nevojat reale të zgjedhësve.

1.10 Për ligjshmërinë e zgjedhjeve të dt. 30 qershor 2019 do të vendosin organet kompetente. Gjithashtu, raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it përbën një udhërrëfyes të rëndësishëm që duhet të lexohet nga të gjithë palët me objektivitet dhe paanshmëri. Por pavarësisht nga kjo, KShH shpreh shqetësimin se situata politike në vend vazhdon të jetë e tensionuar. KShH mendon dhe shpreson se mund dhe duhen gjetur rrugët dhe mekanizmat e zgjidhjes së saj. Qytetarët nuk dëshirojnë një përplasje të tilla të vazhdueshme, në një moment kur për ta në rend të ditës janë problemet social-ekonomike.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

2. Procesi parazgjedhor

2.1. Publikimi i ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë

Në përputhje me nenin 51, pika 4 të Kodit Zgjedhor, **brenda datës 04.12.2018**, zyrat e gjendjes civile, pas miratimit nga kryetari i njësisë vendore, printojnë dhe publikojnë ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre.

Nga monitorimi i realizuar në 8 njësi administrative të Bashkisë Tiranë, ka rezultuar se vetëm dy prej tyre i kanë njohur vëzhguesit me listat e publikuara periodikisht të zgjedhësve.² **Përgjithësisht ekstraktet e përbërësve zgjedhorë nuk janë publikuar në afatin ligjor të caktuar.** Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se muaji Shkurt është shoqëruar me vonesa në publikimin e ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, ndërsa muaji Mars është shoqëruar me publikimin 2 herë brenda muajit të ekstraktit.³

Ekstrakti i përbërësve zgjedhorë rezulton të jetë afishuar vetëm në ambientet e njësive administrative të monitoruara dhe në shkolla. **Aksesi i publikut u kufizua vetëm gjatë orarit zyrtar të punonjësve të njësive si dhe gjatë orarit të pushimit të shkollave. Me përjashtim të ekstrakteve të afishuara në Njësinë nr. 6, ato rezultonin të vulosura dhe të nënshkruara sipas parashikimeve ligjore.**



Vëzhguesit e KShH-së konstatuan në përgjithësi se ekstraktet e përbërësve zgjedhorë janë lehtësisht të dallueshme dhe të lexueshme, të afishuara në lartësi normale në ambientet e brendshme të institucioneve. U konstatuan edhe raste përjashtimore, p.sh.: mënyra e publikimit të ekstrakteve si një regjistër që duhej shfletuar e vështirësonte procesin e gjetjes së emrit nga ana e qytetarëve në Njësinë Administrative nr. 10 në Bashkinë Tiranë etj.⁴

Nga të dhënat e marra nga njësitë administrative të Bashkive të monitoruara nuk rezulton të ketë patur ankesa administrative për korigjimin e listave dhe se interesimi i votuesve për t'u njohur me listën e zgjedhësve ka qënë i paktë.

2.2. Njoftimi me shkrim i zgjedhësve

² Njësitë Administrative nr. 3 dhe nr. 5.

³ Përkatesisht në Njësinë Administrative Nr. 3 vërehet publikimi në dt. 03.03.2019 dhe 29.03.2019, ndërkohë në Njësinë Administrative Nr. 5 konstatohet publikimi i ekstraktit në dt. 04.03.2019 dhe 29.03.2019.

⁴ Mungesa e masave mbrojtëse si p.sh. xham, në Njësinë Administrative nr. 8 dhe 3 në qytetin e Tiranës dhe KZAZ nr. 3 pranë Shkollës "Ismail Qemali" në qytetin e Shkodrës, i shndërron këto ekstrakte në objekte lehtësisht të dëmtueshme nga qytetarët dhe faktorët atmosferikë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Deri në dt. 4 Shkurt 2019⁵, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore duhet të merrnin masa për realizimin e procedurës së njoftimit me shkrim të zgjedhësve. Ky lajmërim, në respektim të nenit 52, pika 2 e KZ, duhet të informonte zgjedhësit lidhur me qendrën e votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhësve.⁶

KShH ka konstatuar se procedura me shkrim e zgjedhësve në Bashkitë e monitoruara në rang vendi nuk është realizuar në përputhje me afatin ligjor. Sipas pretendimit të kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore, si dhe koordinatorëve të autorizuar për administrimin e procesit zgjedhor në nivel rajonal, kjo vonesë vjen si pasojë e mos akordimit të fondit nga ana e Ministrisë së Brendshme, e cila mbulon shërbimin e gjendjes civile.⁷

Më datë 17 Prill 2019, KShH ka njoftuar zyrtarisht Ministrinë e Brendshme, duke sugjeruar marrjen e masave për realizimin e kësaj procedure edhe në tejkallim të afateve ligjore, me qëllim garantimin e publikimit të saktë të listave përfundimtare të zgjedhësve.⁸ Në mungesë të një reagimi nga ana e Ministrisë përgjegjëse, KShH nëpërmjet një njoftimi për shtyp informoi publikun mbi rezultatet e këtij vëzhgimi.⁹



Vëzhguesit e KShH-së na informuan se ka patur Bashki që e kanë realizuar procesin e njoftimit të zgjedhësve përtej afatit ligjor. Kështu, më datë 27 Qershor 2019, pra gati 5 muaj pas përfundimit të afatit ligjor, në qytetin e Elbasanit dhe të Fierit ka nisur procedura e njoftimit me shkrim të zgjedhësve.

2.3. Afishimi i listave përfundimtare të zgjedhësve

Afishimi i listave përfundimtare të zgjedhësve u krijon mundësinë e zgjedhësve të njihen me to dhe në raste të veçanta t'i drejtohen Gjykatës, nëse emri i tyre nuk figuron në lista, por zgjedhësi është i regjistruar në gjendjen civile të zonës përkatëse. Sipas pikës 3 të nenit 56 të Kodit Zgjedhor, KZAZ-të janë të detyruara të shpallin në një vend të dukshëm dhe me akses për zgjedhësit listat përfundimtare të zgjedhësve. Kjo detyrë duhej të kryhej brenda datës 26.05.2019.

Nga monitorimi i pjesshëm i realizuar në 9 Bashkitë në rang vendi rezulton se në shumicën e KZAZ-ve të monitoruara, vëzhguesit e KShH-së konstatuan se në shumicën dërrmuese të tyre janë respektuar afatet ligjore të shpalljes së listave përfundimtare. Mgjth, në KZAZ-të

⁵ Neni 52 i Kodit Zgjedhor

⁶ Deklaratë për shtyp e KShH-së e dt. 19.03.2019.

⁷ Neni 52, pika 5 i Kodit Zgjedhor.

⁸ Shkresë nr. 259 prot., datë 17.04.2019.

⁹ Njoftim për shtyp, dt. 2 Maj 2019. Link: <http://ëëë.ahc.org.al/njoftim-per-shtyp-10/>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

nr. 47, 48 dhe 49 në Elbasan¹⁰ dhe nr. 33 dhe 48 në Tiranë¹¹, vëzhguesit e KShH-së konstatuan se procedura e marrjes në dorëzim të listave përfundimtare ose protokollimi i tyre ishte kryer me vonesë.

Kryetari i KZAZ nr. 41 në Bashkinë Tiranë, vuri në dijeni vëzhguesit e KShH-së se në QV nr. 2023 dhe nr. 2010, është vërejtur rezistencë dhe mosrakordim nga ana e institucioneve shtetërore për të afishuar listat në ambientet e tyre.¹² Gjithashtu, në qytetin e Shkodrës, vëzhguesi i KShH-së ka vërejtur në mënyrë të përsëritur se KZAZ-të nr. 2, 3, 4 dhe 5 nuk kanë të afishuar asnjë tabelë/shenjë identifikuese mbi vendndodhjen e tyre. Në 2 qendrat e vendosura në zonat periferike si Gur i Zi dhe Rrenc nuk është realizuar afishimi i listave përfundimtare të zgjedhësve.



Në disa prej qendrave të votimit është konstatuar se listat janë vendosur në lartësi mbi gjatësinë e një individi të zakonshëm, duke krijuar vështirësi në aksesin e tyre nga qytetarët.

Ashtu si gjatë fazës së afishimit të ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë, vëzhguesit e KShH-së konstatuan se aksesin në listat përfundimtare të zgjedhësve pas orarit zyrtar nuk ka qenë mundur për shkak të kyçjes së ambienteve të jashtme të institucioneve ku ishin afishuar listat.

2.4. Regjistrimi i Subjekteve Zgjedhore

Në përputhje me nenin 64, pika 1 të KZ, regjistrimi i partive politike si subjekte zgjedhore përfundonte në dt. 23 Prill 2019 (sepse data 21 Prill që korrespondonte me ditën e djelë ishte pushim zyrtar)¹³, ndërsa afati për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore përfundonte në dt. 2 Maj 2019 (sepse dt.1 Maj ishte datë pushimi zyrtar)¹⁴. Brenda datës 13 Maj 2019 partitë politike të regjistruara duhet të depozitonin listën shumëemërore të kandidatëve për çdo zonë zgjedhore.

Partitë opozitare (PD dhe aleatët e saj, si dhe LSI-ja) nuk u regjistruan si subjekte zgjedhore. Në këto zgjedhje u regjistruan si subjekte zgjedhore 6 kandidatë të pavarur, të cilët u

¹⁰ Nga anëtarët e këtyre komisioneve, vëzhguesit të KShH-së iu referua se marrja në dorëzim e listave përfundimtare më dt. 29.06.2019. Kjo vonesë ishte shkaktuar për arsye teknike të printimit të tyre.

¹¹ Përfaqësuesit e KZAZ-së pretenduan se marrja në dorëzim është realizuar më parë, por procedura e dokumentimit në protokoll për shkak të ngarkesës është realizuar me vonesë.

¹² Për shkak të rezistencës së qytetarëve, është vërejtur mos realizimi i publikimit të listave në KZAZ nr. 36 në Tiranë, pranë zonës së Astirit. Si zgjidhje, kryetari i kësaj KZAZ-je ka referuar se është realizuar afishimi në të njëjtat ambiente në të cilat është zhvilluar më parë procesi i zgjedhjeve.

¹³ Këtë shtyrje e bëri publike në media, anëtari i KQZ-së, Z. Skënderi: <http://top-channel.tv/video/zgjedhjet-e-30-qershorit-kqz-shtyn-regjistrimin-e-partive/>

¹⁴ Neni 65, i Kodit Zgjedhor.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

propozuan nga zgjedhësit.¹⁵ Në ndryshim nga Zgjedhjet Parlamentare të dt. 25 Qershor 2017 ku nuk u regjistrua asnjë koalicion zgjedhor, në zgjedhjet e Qershorit 2019 u formuan 2 koalicione zgjedhor. PS u regjistrua në koalicion me 21 parti politike.¹⁶ Si koalicion u regjistrua gjithashtu edhe “Shpresa për ndryshim”, e përbërë nga 7 parti politike.¹⁷ Në 31 Bashki kandidoi vetëm një kandidat, duke mos patur përballë kandidatë kundërshtarë.¹⁸ Si kandidatë për anëtarë të Këshillave Bashkiakë në listat e depozituar për të dy koalicionet ishin gjithsej 544 persona.

Numri total i kandidatëve për Kryetar Bashkie në zgjedhjet e qeverisjes vendore ishte 97, ndër të cilët vetëm 11 femra. Kjo shifër tregon një pjesëmarrje dhe përfaqësim të ulët, afro 10% të gruas për të kandiduar në nivel kryetar bashkie. Kodi ynë Zgjedhor nuk parashikon kuotë gjinore për kandidatët që propozohen për kryetar bashkie nga subjektet zgjedhore. Ndërkohë elementi i kuotës gjinore, i parashikuar në nenin 67, pika 6, paragrafi i dytë, sa i takon përfaqësimit në Këshillat Bashkiakë dhe i sanksionuar në nenin 175 Kodit Zgjedhor, rezulton të jetë respektuar nga ana e subjekteve zgjedhore dhe nga KQZ. Vendimarrja e KQZ, lidhur me refuzimin e listave shumëemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive Vlorë dhe Lezhë të Partisë Aleanca Demokristiane, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, u bë objekt shqyrtimi në Kolegjin Zgjedhor. Ky i fundit, nëpërmjet vendimit nr. 3, dt. 30.05.2019, vendosi rrëzimin e padisë së depozituar nga subjekti ankues, duke argumentuar se: *“Është fakt i pakontestuar me padinë në gjykim mosrespektimi nga pala paditëse në paraqitjen e listave shumëemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkive Lezhë e Vlorë të depozituara nga Partia Aleanca Demokristiane për zgjedhjet e pushtetit vendor të datës 30.05.2019, i kriterit të barazisë gjinore”*.

Objekt ankimi pranë Kolegjit Zgjedhor janë bërë disa vendime të KQZ-së, nëpërmjet të cilave është vendosur refuzimi i listës shumëemërore të kandidatëve të depozituar nga ana e subjekteve zgjedhore apo dhe kandidatë të propozuar nga zgjedhësit. Kështu psh, Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 2, dt. 30.05.2019 vendosi rrëzimin e padisë së depozituar nga kandidati për kryetar i Bashkisë Himarë, z.Dhionisios Alfred Beleri, për shkak të ndalesave

¹⁵ E drejtë e ushtruar në përputhje me nenin 69 të Kodit Zgjedhor.

¹⁶ Ky koalicion përfshin 21 parti, përkatësisht: Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, Partia Demokracia Sociale, Partia Kristian Demokrate, Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar, Partia e Gjellbër, Partia G99, Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, Partia Socialpunëtore Shqiptare, Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, Partia Demokratike për Integrim e Prosperitet, Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, Partia Socialiste e Moderuar, Partia Ardhmëria Shqiptare, Partia Unitetit Kombëtar, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, Partia e të Drejtave të Mohuara, Partia Socialiste e Shqipërisë.

¹⁷ Ky koalicion përfshin 7 parti, përkatësisht: Partia Aleanca Popullore, Partia Demokracia e Re Europiane, Partia Balli Kombëtar, Partia Bashkimi Liberal Demokrat, Partia Aleanca Kuq e Zi, Partia Ora e Shqipërisë dhe Partia Emigracionit Shqiptar.

¹⁸ Këto bashki janë: Kuçovë, Poliçan, Skrapar, Ura Vajgurore, Mat, Krujë, Elbasan, Librazhd, Peqin, Divjakë, Fier, Lushnjë, Patos, Roskovec, Dropull, Gjirokastër, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Maliq, Pogradec, Has, Fushë-Arrëz, Pukë, Shkodër, Vau i Dejës, Rrogozhinë, Vorë, Delvinë, Konispol, Himarë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.*

Objekt shqyrtimi në Kolegjin Zgjedhor ishte edhe regjistrimi i subjektit zgjedhor, Partia ‘Bindja Demokratike’¹⁹, bazuar në ankimin e depozituar ndaj vendimit të KQZ-së nga subjekti zgjedhor Partia “Bashkimi Demokrat Shqiptar”. Nëpërmjet vendimit nr. 01, dt. 09.05.2019, Kolegji Zgjedhor vendosi rrezimin e padisë për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv të palës paditëse, duke argumentuar se: *“Në vlerësimin e Kolegjit Zgjedhor pala paditëse nuk gëzon legjitimitetin aktiv pasi nuk cënohen interesat e tij të ligjshme siç mund të jenë edhe kushtet e zhvillimit të zgjedhjeve”.*

Në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të vitit 2015, OSBE/ODIHR ka rekomanduar plotësimin e vakumit ligjor në mënyrë që të përcaktohet momenti kur kandidati mund të dorëhiqet. Kjo nuk është realizuar pasi në Kodin tonë Zgjedhor nuk është bërë ndonjë ndryshim. Në zgjedhjet e dt.30 Qershor 2019 u vërejt se pati kërkesa për dorëheqje të dy kandidatëve për kryetar Bashkie, përkatësisht të z. Salvator Kaçaj (Lezhë) dhe z. Bledar Sinella (Kavajë). Për këtë të fundit, KQZ vendosi referimin e rastit për kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.²⁰ Rasti i kandidatit Z. Salvator Kaçaj, i propozuar nga partia Bindja Demokratike u bë objekt shqyrtimi në Kolegjin Zgjedhor.²¹ Në Kolegji kandidati nuk kundërshtoi drejtpërsëdrejti vendimin e KQZ-së për mospranimin e dorëheqjes²², por kërkoi shfuqizimin e vendimit të KQZ-së për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit. Ndërkohë, Kolegji Zgjedhor argumenton se: *“mungesa e parashikimit në Kodin Zgjedhor të të drejtës së kandidatit të regjistruar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore për të hequr dorë nga kandidimi dhe, më tej, të të drejtës së subjektit zgjedhor (subjektit politik) për zëvendësimin e kandidatit të regjistruar të saj dhe të dorëhequr pas regjistrimit të tij rregullisht, tregon se qëllimi i ligjvënësit ka qenë pikërisht mosdhënia nëpërmjet mosnjohjes pozitivisht të këtyre të drejtave për këto subjekte zgjedhore”.*²³

Kërkesë për t’u ç’regjistruar nga procesi zgjedhor, gjatë zgjedhjeve të dt. 30 Qershorit 2019, depozitoi edhe partia “Uniteti Kombëtar”. Vendimarrja e KQZ-së²⁴ ndaj këtij subjekti iu nënshtrua shqyrtimit gjyqësor pranë Kolegjit Zgjedhor. Duke u referuar në precedentët e mëparshëm, vendimet nr. 22, dt. 20.06.2015 dhe nr. 18, dt. 05.06.2015, Kolegji argumentoi gjithashtu se: *“Tërheqja / ç’regjistrimi apo zëvendësimi i kandidatëve nga subjektet zgjedhore, pas miratimit dhe shpalljes së listave dhe regjistrimit të kandidatëve apo, më tej, edhe pas përgatitjes së materialit zgjedhor përkatës do të përbënte një rrezik për stabilitetin dhe transparencën e procesit zgjedhor dhe ushtrimin e së drejtës themelore të votës”.*²⁵

¹⁹ Ky subjekt zgjedhor u regjistrua nëpërmjet Vendimit të KQZ-së nr. 230, dt. 27.04.2019.

²⁰ Vendim i KQZ-së nr. 639, dt. 22.05.2019 *“Për shqyrtimin e kërkesës së tërheqjes nga kandidimi për kryetar të Bashkisë Kavajë Z. Bledar Sinella, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 Qershor 2019”.*

²¹ Vendim i Kolegjit Zgjedhor nr. 9, dt. 06.06.2019.

²² Vendim nr. 638, dt. 22.05.2019.

²³ Vendim i Kolegjit Zgjedhor nr. 18, dt. 06.05.2015.

²⁴ Vendim nr. 836, dt. 13.06.2019.

²⁵ Vendim i Kolegjit Zgjedhor nr. 12, dt. 24.06.2019.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

2.5. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve²⁶

KShH ka monitoruar pjesërisht veprimtarinë e organit më të lartë të administrimit zgjedhor, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Në kushtet e mospërfaqësimit të forcave opozitare në organet e të trija niveleve të administrimit zgjedhor dhe situatës politike të pazakontë në të cilat u zhvilluan këto zgjedhje, KQZ u përball me një volum të madh dhe vështirësi në veprimtarinë e tij.

Vendimet e KQZ-së, të cilat janë bërë në disa raste objekt ankimi në Kolegjin Zgjedhor, rezultojnë se janë publikuar në faqen e KQZ-së të pashoqëruara me mendimin në pakicë ose atë paralel të anëtarëve të tij. Pavarësisht se nuk është i detyrueshëm publikimi i tyre, kemi mendimin se kjo do ta bënte veprimtarinë e KQZ-së më transparente dhe më të hapur ndaj mbikëqyrjes së publikut.

Ditën e votimit dhe pjesërisht gjatë monitorimit, komunikimi i KQZ-së me median dhe publikun shkaktoi në disa raste konfuzion dhe paqartësi. KShH vlerëson se, nuk është as e rregullt dhe as etike që zëdhënësi i këtij organi të kundërshtohet nga kryetari i KQZ-së për të dhënat e bëra publike. Kjo cenoi parimin e transparencës karshi publikut.

Gjatë administrimit të procesit parazgjedhor për çështje të diskutueshme u konstatua se anëtarët nuk mundën të shmangin influencat e natyrës politike. Në mbledhjen e KQZ-së dt. 10.06.2019, gjatë diskutimeve mbi fuqinë juridike të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11199/2019, kryetari i këtij institucioni u largua duke bojkotuar punimet e mbledhjes. Rikthimi i kryetarit të KQZ-së u konstatua pas 10 ditësh, më dt. 21.06.2019, por vendimarrjet e KQZ-së në shumicën e tyre janë marrë me 4 vota pro dhe 1 kundër duke mos reflektuar një frymë unanimiteti. Kjo siç do të analizohet më vonë krijoi pengesa për miratimin e akteve normative pas ditës së zgjedhjeve nga ky organ.

KShH, ashtu si në zgjedhjet e mëparshme, edhe në zgjedhjet e dt.30 Qershor 2019 ka sinjalizuar KQZ-në për disa pengesa që vëzhguesit tanë kanë hasur gjatë procesit të monitorimit të Qendrave të votimit. KQZ në fakt nuk ka reaguar për këto pengesa.²⁷

2.6 Bordi i Monitorimit të Medias

Pavarësisht se nuk ka qenë në fokusin kryesor të monitorimit, Bordi i Monitorimit të Medias (BMM), i cili sipas Kodit Zgjedhor duhej të ngruhej më dt. 22 Prill 2019²⁸, u ngrit më shumë se një muaj me vonë, më dt. 28.05.2019.²⁹ Nga momenti i konstituimit BMM ka përpiluar 20 raporte periodike ditore dhe 4 raporte javore.

²⁶ KZAZ nr. 56 dhe 57

²⁷ Përkatesisht Znj. Emira Ymeraj, ka kufizuar aksesin e vëzhguesit të KShH-së gjatë procesit të monitorimit të numërimit pranë KZAZ nr. 5 në qytetin e Shkodrës.

²⁸ Neni 85, pika 1, i Kodit Zgjedhor.

²⁹ Vendim nr. 694, dt. 28.05.2019.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Më dt. 25 Qershor 2019, KShH u njoh me publikimin e sondazhit zgjedhor të publikuar në një media shqiptare. Botimi i këtij sondazhi binte ndesh me kufizimet ligjore të vendosura në nenin 78, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ndaj KShH vuri në dijeni për këtë KQZ-në, e cila më pas njoftoi subjektin konkret.³⁰ KShH vlerëson se KQZ dhe BMM duhet të ishin më vigjilent dhe më proaktiv, ndaj cënimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor që parashikon afatet e fillimit të fushatës zgjedhore si edhe afatet që ndalojnë publikimin e rezultateve të sondazheve zgjedhore.

2.6. Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve dhe KQV-ve

KShH monitoroi pjesërisht ngritjen dhe funksionimin e 28 Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) në rang vendi.³¹ Me vendimin nr. 16, datë 18.01.2019³², KQZ vendosi që territori i 90 Zonave të Administrimit Zgjedhor (ZAZ) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019 do të ishte në 61 njësitë qeverisjes vendore, në 12 qarqe të vendit.

Gjatë monitorimeve të realizuara vëzhguesve të KShH-së kryesisht nuk i është kufizuar aksesi, me përjashtim të KZAZ nr. 2, 3, 4 dhe 5 në qytetin e Shkodrës. Afati ligjor 18.03.2019, brenda të cilit partitë politike duhet të propozonin kandidaturat përkatëse për anëtar të KZAZ-së nuk është respektuar nga forcat politike opozitare. Me anë të vendimit nr. 114, datë 02.04.2019, KQZ miratoi në përputhje me afatin e parashikuar në Kodin Zgjedhor, kandidaturat e propozuara për anëtar KZAZ-je vetëm nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste". KQZ emëroi kryesisht anëtarët e KZAZ-së, deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimarrje në KZAZ.³³ KShH vëren se bojkoti nga ana e partive politike të opozitës parlamentare ka ndikuar në mosrespektimin e parashikimit ligjor të pikës 2 të nenit 29 KZ, i cili parashikon përkatësinë e kundërt të kryetarit të KZAZ-së nga zv/kryetari.

Më dt. 20 Maj 2019, forcat opozitare ju drejtuan KQZ-së për të kërkuar zëvendësimin e anëtarëve të KZAZ-ve të emëruar kryesisht nga KQZ, me anëtarët e propozuar prej tyre. Ky propozim është paraqitur në një moment kur ato nuk ishin regjistruar si subjekt zgjedhor, ndërkohë që partitë politike marrin cilësinë e subjektit zgjedhor kur regjistrohen si të tillë brenda afateve të parashikuara në K.Zgjedhor. Kjo kërkesë u rrëzua nga ana e KQZ-së,³⁴ ndërsa çështja u bë objekt shqyrtimi pranë Kolegjit Zgjedhor. Kolegji vendosi

³⁰ Nëpërmjet Shkresës nr. 12627 prot., dt. 28.06.2019, KQZ ju drejtua subjektit për të marrë masa për të hequr nga faqja e ëebit sondazhin përkatës.

³¹ Përkatësisht: 7 KZAZ në qytetin e Tiranës, 4 KZAZ në qytetin e Vlorës, 3 KZAZ në qytetin e Durrësit, 3 KZAZ në qytetin e Fierit, 4 KZAZ në qytetin e Shkodrës, 2 KZAZ në qytetin e Korçës, 1 KZAZ në qytetin e Gjirokastrës dhe 4 KZAZ në qytetin e Elbasanit.

³² <http://cec.org.al/vendime-2019/>

³³ Në bazë të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar nga KZAZ dhe KQV", të ndryshuar me Udhëzimin nr. 127, datë 04.04.2019, KQZ më datë 20.03.2019 publikoi njoftimin për shprehje interesi nga shtetas të cilët janë të gatshëm për realizimin e këtij funksioni dhe plotësojnë kriteret e parashikuara.

³⁴ Vendim nr. 657, dt. 23.05.2019.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

rrëzimin e padive të depozituara, duke argumentuar se: *“Në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, partitë politike legjitimohen të drejtohen Kolegjit Zgjedhor duke kundërshtuar vendimarrjen e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve vetëm në rastet kur është refuzuar kërkesa për regjistrimin si subjekt zgjedhor”*.³⁵

Deri më datë 29.06.2019, KShH ka konstatuar se KQZ ka marrë vendim në 32 raste për të liruar nga detyra dhe emëruar anëtarët/sekretarët e KZAZ-ve.³⁶ KQZ ka bërë zëvendësimin e anëtarëve të dorëhequr ose të anëtarëve të cilët nuk janë paraqitur në tre mbledhje rrjesht të KZAZ-ve, ose mbi bazën e kërkesës së subjektit propozues P.Socialiste.



KZAZ-të e monitoruara nga ana jonë nuk kanë funksionuar plotësisht sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor.³⁷ Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se elementët identifikues të vendodhjes së KZAZ-ve me qëllim garantimin e aksesueshmërisë së zgjedhësve nuk janë respektuar.³⁸ Ambientet e KZAZ-ve në katet e dyta dhe të treta të shkollave nuk kanë qenë të përshtatshme për realizimin e mbledhjeve.

Janë referuar raste kur vëzhguesit e KShH-së janë paraqitur në orare të ndryshme brenda ditës apo edhe në ditë të ndryshme pranë këtyre ambienteve, por nuk kanë gjetur asnjë përfaqësues të KZAZ-ve. Nga kontakti i marrë me shumicën e anëtarëve të KZAZ-ve të monitoruara nuk rezulton të ketë patur kërkesa nga zgjedhësit për lëshimin e vërtetimeve, nëse emri i tyre gjendet në listat përfundimtare të zgjedhësve.

Në datat 8 dhe 9 Maj 2019, KQZ realizoi trajnimin e Komisionerëve të KZAZ-ve në të

³⁵ Vendim i Kolegjit Zgjedhor nr. 10, dt. 06.06.2019.

³⁶ Vendimet e shqyrtuara janë: nr. 172, dt. 16.04.2019; nr. 173, dt. 16.04.2019; nr. 183, dt. 23.04.2019; nr. 216, dt. 27.04.2019; nr. 250, dt. 07.05.2019; nr. 274, dt. 10.05.2019; nr. 348, dt. 15.05.2019; nr. 606, dt. 21.05.2019; nr. 609, dt. 21.05.2019; nr. 610, dt. 21.05.2019; nr. 640, dt. 23.05.2019; nr. 652, dt. 26.05.2019; nr. 658, dt. 27.05.2019; nr. 670, dt. 28.05.2019; nr. 698, dt. 28.05.2019; nr. 726, dt. 30.05.2019; nr. 751, dt. 01.06.2019; nr. 793, dt. 03.06.2019; nr. 794, dt. 03.06.2019; nr. 802, dt. 06.06.2019; nr. 829, dt. 10.06.2019; nr. 846, dt. 21.06.2019; nr. 854, dt. 22.06.2019; nr. 863, dt. 25.06.2019; nr. 877, dt. 26.06.2019; nr. 880, dt. 26.06.2019; nr. 883, dt. 27.06.2019; nr. 901, dt. 27.06.2019; nr. 902, dt. 27.06.2019; nr. 914, dt. 28.06.2019; nr. 922, dt. 28.06.2019; nr. 935, dt. 29.06.2019.

³⁷ P.sh.: Nga komunikimi i vëzhguesit të KShH-së me rojen e KZAZ-së nr. 2 në qytetin e Shkodrës, ai është shprehur (citojmë): *“Anëtarët e KZAZ-së janë paraqitur vetëm një ditë në ambientet e pallatit të sportit, kanë marrë një zyrë, i kanë ndërruar bravën dhe nuk janë paraqitur më”*. Vëzhguesi i KShH-së konstatoi se KZAZ nr. 82, në qytetin e Vlorës nuk ka vazhduar *de facto* veprimtarinë e saj. Në këtë ambient nuk është konstatuar asnjë element identifikues i KZAZ-së, ndërkohë që sekretarja e kontaktuar u shpreh se akoma nuk i është vënë në dispozicion çelësi i zyrës.

³⁸ Menjëherë pas konstitiumit, KZAZ vendos flamurin kombëtar në një vend të dukshëm; bën publike në hyrjen e KZAZ kopjen e dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë për caktimin e datës së zgjedhjeve zgjedhjeve; emrat e anëtarëve të KZAZ-së dhe sekretarit; etiketën [shenjën dalluese] për identifikimin e KZAZ-së; adresën, numrat e kontaktit dhe orarin e punës së KZAZ-së.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

gjithë vendin.³⁹ KShH konstatoi se edhe në këto zgjedhje pati zëvendësime të anëtarëve/sekretarëve të KZAZ-ve, pas trajnimit të realizuar nga KQZ. Praktika e ndryshimit të anëtarëve të KZAZ-ve pas kërkesës së depozituar nga ana e subjektit zgjedhor propozues është kritikuar edhe në zgjedhjet e mëparshme nga KShH, por nuk ka gjetur përmirësim.

Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar disa parregullsi në mënyrën e dokumentimit të veprimtarisë së KZAZ-ve të monitoruara.⁴⁰ Së pari, është vërejtur që në disa raste publikimi i vendimeve nuk ndjek të njëjtin standart. Mospërfaqësimi në këto KZAZ i anëtarëve të propozuar nga opozita ka sjellë vendimmarrje unanime të tyre. Vëzhguesit e KShH-së nuk kanë mundur të verifikojnë të gjithë dokumentacionin e KZAZ-ve, për shkak të mosadministrimit të tij në ambientet e KZAZ-ve. Në fakt këto dokumente duhet të administrohen në ambientet e brendshme të KZAZ-ve dhe të jenë të siguruara nga ndërhyrjet e jashtme dhe të paautorizuara.

Nga monitorimi i pjesshëm i realizuar nga KShH, rezulton se vetëm subjekti zgjedhor Partia Socialiste ka depozituar brenda afatit 30 Maj 2019⁴¹, propozimet për anëtarë/sekretarë të KQV-së. Vëzhguesit e KShH-së janë vënë në dijeni se forcat opozitare, PD dhe LSI kanë depozituar gjithashtu listë shumëmërore të kandidatëve për anëtarë/sekretarë të KQV-ve, por këto lista janë refuzuar nga KZAZ-të.

Vonesa janë vërejtur në emërimin kryesisht të anëtarëve/sekretarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV).⁴² Në dt.04.04.2019, KQZ ka marrë vendimin nr. 127 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 4, datë 19.02.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”. Si bazë ligjore e këtij vendimi është referuar neni 23, pika 1 gërma "a", pika 2 dhe 5, neni 29, pika 5, neni 36, pika 5 të Kodit Zgjedhor të RSH.

Vendimi i mësipërm i KQZ-së është i diskutueshëm pasi praktikisht i jep disa tagra KQZ-së të cilat nuk i janë akorduar në Kodin Zgjedhor, dhe më konkretisht për të plotësuar vakancat e krijuara në KQV, duke i propozuar KZAZ-së listat e shtetasve që mund të emërohen anëtarë apo sekretarë të KQV-ve. Sikurse dihet, udhëzimet e KQZ-sa dalin në bazë dhe për zbatim të ligjit që është Kodi Zgjedhor. Udhëzimet nuk mund të parashikojnë dispozita që

³⁹ Deklaratë për shtyp KQZ, dt. 07.05.2019. Link: <http://cec.org.al/deklarate-3/>

⁴⁰ P.sh.: Në KZAZ-të nr. 30 dhe 36 në qytetin e Tiranës nuk rezulton e dokumentuar asnjë vendimmarrje në Regjistrin e Vendimeve, ndërkohë që këto KZAZ rezultojnë të konstituara por ky moment ligjor nuk është pasqyruar. Gjithashtu, anëtarët e KZAZ-së nr. 24, në qytetin e Durrësit, i kanë referuar vëzhguesit të KShH-së se kanë mbajtur një mbledhje me qëllim marrjen e bazës materiale dhe vendimin për 3 propozimin e kryetarit të KZAZ-së. KShH konstaton se kjo mbledhje nuk gjendej e pasqyruar në Librin e Protokollit të Mbledhjeve. Ky fakt i konstatuar bie ndesh me detyrimin ligjor të parashikuar në nenet 13, pika 2, gërma ç), 23 pika 5 KZ, si dhe Udhëzimin nr. 2/2009 të KQZ-së.

⁴¹ Neni 36, pika 2, i Kodit Zgjedhor.

⁴² Udhëzim nr. 4, dt. 19.02.2013, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar nga KZAZ dhe KQV”, ndryshuar nëpërmjet Vendimit të KQZ-së nr. 127, dt. 04.04.2019.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

bien ndesh me dispozitat e Kodit. Në fakt në nenin 33, gërma “b”, Kodi Zgjedhor parashikon se është KZAZ-ja ajo që emëron kryetarin, zëvendëskryetarin, anëtarët, sekretarët e KQV-ve, dhe anëtarët e grupeve të numërimit, të përfshira në juridiksionin e ZAZ-së, sipas këtij Kodi. Ndërkohë, sipas nenit 36, pika 5 të Kodit Zgjedhor, është pikërisht KZAZ, si organ i administrimit të procesit zgjedhor në nivel të dytë, që duhet të marrë masa për plotësimin kryesisht të vakancës së krijuar nga KQV. Është i diskutueshëm fakti që KQZ i ka dërguar KZAZ-së listën me emrat e anëtarëve që mund të emërohen në këto pozicione vakante, pasi ka paracaktuar në këtë mënyrë procedurën e përzgjedhjes, duke mos i lënë diskrecion vetë KZAZ-së për të identifikuar, verifikuar kandidaturat dhe më pas për të bërë përzgjedhjen e tyre. Referuar nenit 3/1 të Udhëzimit të vitit 2013, të ndryshuar me vendimin nr.127 të KQZ-së, praktikisht i vetmi diskrecion që KZAZ ka patur është të emërojë anëtarin apo sekretarin e KQV-së, me emrat nga lista e miratuar me vendim të KQZ-së, ose në rastin kur numri i shtetasve në listën e miratuar nga KQZ është më i madh se numri i vakancave, KZAZ ka organizuar në seancë publike hedhjen e shortit për përzgjedhjen e tyre.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga KQZ, rezulton se 5441 KQV në rang vendi përbëhen nga 4 anëtarë dhe janë trajnuar gjatë datave 22.06.2019 – 27.06.2019 ose e thënë ndryshe, 3 – 7 ditë para ditës së votimit.⁴³

2.7. Fushata zgjedhore

Aktivitetet politike me natyrë elektorale të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste” filluan para afatit ligjor (31 Maj 2019). Kjo fushatë e parakohshme bie ndesh me përmbajtjen dhe frymën e nenit 77 të Kodit Zgjedhor, ndaj KShH iu drejtua KQZ-së me një letër publike.⁴⁴ Përfaqësuesit e KQZ-së kërkuan takim lidhur me këtë çështje. KShH vlerëson se kërkimi i takimeve për provueshmërinë e fakteve të cilat janë publike, tregon mungesë të kurajos dhe pavarësie të KQZ-së për tu përballur me forcat politike për këto raste.

Nuk është në misionin e KShH-së të vlerësojë aktin e dorëheqjes nga mandatet, nga deputetët e opozitës. M gjith, kjo ndikoi në krijimin e një atmosfere të tensionuar politike dhe u shoqërua me incidente të dhunshme gjatë fushatës zgjedhore (kryesisht djegie të KZAZ-ve apo protesta me elementë të dhunshëm), të cilat u përshkallëzuan disa ditë para votimit. Nga të dhënat e bëra publike nga Policia e Shtetit, në ngjarjet e dhunshme ndaj KZAZ në nivel kombëtar janë përfshirë 250 autorë nga të cilët 59 janë arrestuar, 138 ndiqen në gjendje të lirë dhe 53 janë shpallur në kërkim.⁴⁵

⁴³ Skema e trajnimit të anëtarëve të KQV-së na është vënë në dispozicion nëpërmjet emailit më dt. 24.06.2019 nga ana e Drejtorit të DKZTEZ të KQZ-së.

⁴⁴ Shkresë nr. 206 Prot., datë 27.03.2019.

⁴⁵ Burim informacioni: <https://shekulli.com.al/dë-heshtje-zgjedhore-ne-shqiperi-me-incidente-te-mosbindjes-civile/>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Pavarësisht VKM nr. 283/2019⁴⁶ dhe ngritjes së Task Forcës nga ana e Këshillit të Ministrave, vëzhguesve të KShH-së në Bashkitë Fier dhe Shkodër i'u janë përcjellë pretendime për shfrytëzimin e administratës publike për qëllime propagandistike zgjedhore si dhe për faktin se punonjësve ju është kërkuar që të votojnë dhe të sigurojnë pjesëmarrjen e një numri të caktuar vëzhguesish nga familjarët e tyre. Ndërkohë, punonjësit kanë kërkuar ruajtjen e anonimatit për shkak të rrezikut që mund ti krijohet në vendin e tyre të punës.

KShH vlerëson se subjektet zgjedhore të regjistruara për zgjedhjet e qeverisjes vendore, duhet të evidentonin gjatë fushatës se çfarë kriteresh ndoqën për kandidaturat e përzgjedhura prej tyre për kryetar Bashkie osë anëtarë të Këshillave Bashkiakë. Kjo jo vetëm në vështrim të zbatimit të parimit të transparencës, por edhe për faktin se tek ne vazhdon të zbatohet sistemi proporcional rajonal me lista të mbyllura.

3. Procesi i votimit

3.1. Heshtja Zgjedhore

Data 29 Qershor 2019 që simbolizon ditën përpara datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve, deri në mbylljen e votimit përbën heshtjen zgjedhore.⁴⁷

Vëzhguesi i KShH-së gjatë monitorimit të procesit të votimit (rreth orës 08.11 të dt. 30.06.2019) në QV nr. 1729 dhe nr. 1729/2 pranë Liceut Artistik në qytetin e Tiranës, referoi se protesta në ambientet e jashtme po shqetësonte dhe intimidonte zgjedhësit. Gjithashtu, vëzhguesi i KShH-së na ka informuar se rreth orës 12:36 të datës 30.06.2019, në ambientet e jashtme të QV nr. 1494, ZAZ nr. 23 pranë Pallatit të Kulturës 'Aleksandër Moisiu' në qytetin e Durrësit ka pasur një konfrontim verbal ndërmjet militantëve të PD-së dhe komisionerëve.

Në deklaratat e bëra publike në media nga përfaqësues të forcave opozitare, KShH ka vërejtur thirrje të përsëritura duke inkurajuar dhe nxitur zgjedhësit për të mos marrë pjesë në votime.

3.2. Veprimet paraprake dhe hapja e Qendrave të votimit

Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se në rreth 76.5% të QV-ve të monitoruara, votimi është hapur në orarin e parashikuar në ligj, në orën 07.00.⁴⁸ Ndërsa në rreth 23.5% të QV-ve të monitoruara, votimi është hapur me 20-30 minuta vonesë. Shkaqet kanë qenë të lidhura me faktin që anëtarët e KQV-ve nuk kanë njohur siç duhet veprimet paraprake sipas Kodit

⁴⁶ VKM nr. 283, dt. 10.05.2019, "Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet Vendore për vitin 2019".

⁴⁷ Neni 77, pika 2, i Kodit Zgjedhor.


⁴⁸ Neni 11, i Kodit Zgjedhor.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Zgjedhor, pasi kanë ngatërruar kutitë dhe kodet e sigurisë, kanë patur mungesë organizimi, kanë ardhur me vonesë, etj. Vëzhguesi i KShH-së konstatoi se në QV nr. 4510, ZAZ nr. 82 pranë Shkollës ‘Ali Demi’ në qytetin e Vlorës, votimi u hap në orën 06:46 dhe për këtë u mbajt procesverbal, por kjo situatë bie ndesh me nenin 102, pika 1 KZ.

Mendojmë se një tjetër shkak që ndikoi në hapjen me vonesë të QV ishte ndryshimi i vendndodhjeve të tyre. Në harkun kohor 03.06.2019 – 30.06.2019, KQZ ka marrë 17 vendime për ndryshimin e 318 QV-ve. KQZ u detyrua të realizojë këto ndryshime për shkak të situatës së krijuar, veçanërisht incidenteve të dhunshme dhe pengesave apo rezistencës së hasur në disa Bashki të vendit.



KShH konstatoi parregullsi gjatë procedurës së veprimeve paraprake të KQV-së për vendosjen e dhomës së fshehtë, me qëllim që të sigurohej fshehtësia e votimit.⁴⁹ Raste më të shpeshta, për të cilat vëzhguesit e KShH-së depozituan vërejtje me shkrim u konstatuan në Bashkinë Vlorë, QV nr. 4497/1, pranë Shkollës së Mesme Industriale, QV nr. 4510, pranë Shkollës ‘Ali Demi’, QV nr. 4492, pranë Fakultetit të Infermierisë, QV nr. 4440, pranë Shkollës 9-vjecare ‘Rilindja’. E njëjta situatë u vërejt në QV nr. 259/1 në qytetin e Shkodrës, ku kamera të televizionit kombëtar kanë filmuar nga lart procesin e votimit të një zgjedhësi, duke e cënuar në mënyrë flagrante parimin e fshehtësisë së votës.⁵⁰ Në këtë rast, vërejtja e depozituar me shkrim nga ana e vëzhguesit nuk u protokollua. Vëzhguesi i KShH-së në QV nr. 4440, pranë Shkollës ‘Rilindja’ në Vlorë ka referuar se dhoma e fshehtë e posaçme për zgjedhësit me aftësi të kufizuara është vendosur shumë pranë dritares, duke krijuar mundësi për cënimin e fshehtësisë së votës.

3.3. Aksesit i vëzhguesve të KShH-së gjatë votimit

91 vëzhguesit e KShH-së të akredituar nga ana e KQZ-së, të cilët u përfshinë në monitorimin e procesit të ditës së votimit në 9 Bashki të vendit. U depozituan rreth 85

⁴⁹ Neni 101, pika 1, gërma a), i Kodit Zgjedhor.

⁵⁰ Link: <https://opinion.al/ndodh-ne-shkoder-transmetohet-live-ne-tv-vota-e-qytetareve/>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

vërejtje me shkrim. Numri më i madh i vërejtjeve me shkrim u depozituan pranë KQV-ve të monitoruara në qytetin e Vlorës dhe të Tiranës.

Në mënyrë të përsëritur, vërejtjet e depozituara nga vëzhguesit e KShH-së nuk janë protokolluar nga sekretari i KQV-së, në kundërshtim me detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 41, gërma “g” të KZ. P.sh: në QV nr. 1569/1 pranë Gjimnazit ‘Ibrahim Rugova’ në Kamëz, vëzhguesi i KShH-së ka depozituar vërejtje me shkrim për shkak se ka konstatuar cënim të nenit 108 KZ. Kjo vërejtje është protokolluar me rreth 30 min vonesë, për shkak se KQV-ja nuk ishte e pajisur me librin e protokollit. Gjithashtu, nga ana e kryetares së QV nr. 4510, pranë Shkollës “Ali Demi” në Vlorë, vëzhguesit të KShH-së i është refuzuar marrja në dorëzim e vërejtjeve me shkrim, duke pretenduar se ajo nuk e disponon një të drejtë të tillë. Në QV nr. 4258/1, në Gjirokastrë, anëtarët e KQV-së kanë grisur vërejtjen e depozituar me shkrim të vëzhgueses së KShH-së. Shqetësues është fakti se në qytetin e Durrësit, vëzhguesi i KShH-së është përballur me kërcënime intimiduese nga një vëzhgues partiak kur ka bërë vërejtje me shkrim ndaj KQV-së.

Vëzhguesit e KShH-së kanë vërejtur prezencën e personave të paautorizuar, në ambientet e



brendshme të QV dhe në ambientet e jashtme, brenda perimetrit të godinës ku ishin vendosur këto QV. Kryesisht në oborrin e jashtëm të Shkollës ‘Bardhyl Popa’ në qytetin e Elbasanit, ku ishin vendosur QV nr. 2374, nr. 2374/1, nr. 2373 dhe nr. 2373/1, janë vërejtur grupe të të rinjve të identifikuar si përfaqësues të partive politike, të cilët orientonin zgjedhësit apo thjesht mbikëqyrnin zgjedhësit që hynin dhe dilnin nga këto godina. Në QV nr. 1472, ZAZ nr. 23 pranë Universitetit ‘Aleksandër Moisiu’ të qytetit të Durrësit dhe QV nr. 4258/1, ZAZ nr. 78, pranë Universitetit në qytetin e Gjirokastrës, persona të paautorizuar prezantoheshin si vëzhgues partiak dhe informoheshin për numrin zgjedhor të zgjedhësit që voton, çka nuk është e lejueshme sepse në këtë mënyrë identifikohet zgjedhësi që voton apo që nuk voton. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në qytetin e Tiranës, në QV nr.18311, ZAZ nr. 35 pranë Kopshtit nr. 25, në QV nr. 1889/1 dhe 1889, ZAZ nr. 37 pranë Shkollës ‘Gustav Mayer’, në QV nr. 1867, ZAZ nr. 36 pranë Shkollës ‘Musine Kokalari’ etj.

Anëtarët e KQV-ve, në disa raste kanë kërkuar opinion për procedura të caktuara të procesit zgjedhor. Nuk kanë munguar rastet, në të cilat anëtarët e KQV-ve i kanë kërkuar vëzhguesve autorizim nga KZAZ-të, edhe pse ata janë vëzhgues të akredituar nga KQZ, si dhe është tentuar që t’ju lexohen pyetësorët me të cilët ata kanë qenë të pajisur.⁵¹

3.4. Respektimi i procedurave ligjore gjatë votimit

Në shumicën dërrmuese të QV të monitoruara, komisionerët ishin të organizuar dhe kishin ndarë detyrat në administrimin e procesit të votimit. Vetëm në 3.2 % të QV të monitoruara

⁵¹ P.sh.: në QV nr. 4501, ZAZ nr. 82, pranë Shkollës ‘Avni Rustemi’ në Qarkun e Vlorës.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

është konstatuar se tek anëtarët e KQV-ve nuk kishte ndarje pune, sa i takon zhvillimit të procesit të votimit, ëndërsa në rreth 10% të tyre ka rezultuar se anëtari i ngarkuar me detyrën për të mbajtur radhën e zgjedhësve nuk e ka kryer këtë detyrë. Shkaku më i zakonshëm ka qenë mungesa e radhës së zgjedhësve në QV.

Mungesë e kontrollit të zgjedhësit në të dy duart është vërejtur në 7.9% të QV të monitoruara, ndërkohë që në 92.1% ky detyrim ligjor i parashikuar në pikën 1, gërma b) të nenit 105 KZ rezulton se është respektuar. Gjithashtu, vëzhguesit e KShH-së kanë adresuar vërejtje verbale (p.sh.: në QV nr. 1830, ZAZ nr. 35 pranë Shkollës ‘Dëshmorët e Lirisë’, në QV nr. 1867, ZAZ nr. 36 pranë Shkollës ‘Musine Kokalari’ etj.), si dhe vërejtje me shkrim në 6.3% të QV të monitoruara, pasi zgjedhësi nuk timbrosej në dorën e majtë.⁵²

Në raste sporadike në QV-të e monitoruara u konstatua se nuk i hiqej vizë emrit të zgjedhësit në listë, para se të firmoste. Pas depozitimit të vërejtjeve të vëzhguesve të KShH-së në QV nr. 1867, ZAZ nr. 36 pranë Shkollës ‘M.Kokalari’ dhe QV nr. 1985, ZAZ nr. 40 pranë Shkollës ‘D.Distria’, si dhe në QV nr. 4490, ZAZ nr. 84 pranë Pallatit të Kulturës në qytetin e Vlorës, anëtarët e KQV-ve respektive kanë korrigjuar këtë praktikë.

Një nga shkaqet për të cilat vëzhguesit e KShH-së kanë depozituar vërejtje me shkrim është largimi i anëtarëve të KQV-së nga QV në mënyrë të përsëritur dhe pa e dokumentuar në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.⁵³

Në 100% të QV të monitoruara, nga ana e komisionerëve janë verifikuar dokumentet e identifikimit të zgjedhësve. Mgjith ka patur raste sporadike si në QV nr. 3675, ZAZ nr. 72 pranë Shkollës ‘Themistokli Gërmenji’ në qytetin e Korçës në të cilën zgjedhësi nuk është lejuar të votojë me arsyetimin se karta e identitetit ka skaduar. Pas adresimit të vërejtjes verbale nga ana e vëzhgueses së KShH-së, bazuar në Ligjin nr. 11/2019⁵⁴, zgjedhësi është lejuar që të ushtrojë të drejtën e tij për të votuar.

Nuk janë konstatuar raste kur zgjedhësit të jenë paraqitur për të votuar me vendim gjyqësor.

Në 92% të rasteve është zbatuar parashikimi ligjor i reflektuar në nenin 106, pika 1 të KZ, dhe zgjedhësi ka hyrë i vetëm në dhomën e fshehtë ose ka patur raste sporadike kur hyrë me anë të një zgjedhësi që e ka ndihmuar për shkak të aftësive të kufizuara. Parimi i fshehtësisë së votës është cënuar nga 2 komisionerët e QV nr. 4501, pranë Shkollës ‘Avni Rustemi’ në Vlorë, të cilët nuk kanë votuar në dhomën e fshehtë, por në tryezën ku qëndrojnë komisionerët e tjerë. Vëzhguesit e KShH-së kanë vërejtur se zgjedhësit kanë bashkëbiseduar gjatë votimit me anëtarët e familjes në QV nr. 4447, pranë Shkollës ‘Halim Xhelo’ në Vlorë dhe në QV nr. 1430, pranë Shkollës ‘Naim Babameto’ në Durrës. Në 8% të QV të monitoruara janë raportuar raste të votimit familjar (p.sh.: në QV nr. 4491, pranë Pallatit të

⁵² Neni 105, pika 1, gërma dh), i Kodit Zgjedhor.

⁵³ Neni 102, pika 2, i Kodit Zgjedhor.


⁵⁴ Ligj nr. 11/2019, “Për një shtesë në Ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002 ‘Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë’ të ndryshuar” ka vendosur zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së letërnjoftimeve elektronike deri në datën 31.12.2019.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Kulturës, në Vlorë). Është pozitiv fakti se në raport me zgjedhjet e kaluara konstatohet një ulje e ndjeshme e këtyre rasteve.⁵⁵

Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar një rast sporadik të fotografimit të votës në QV nr. 4460, ZAZ nr. 84 pranë Shkollës 'Lef Sallata'. Nga ana e anëtarëve të KQV-së, situata i është referuar KZAZ-së përkatëse.



Vëzhguesit e KShH-së raportuan se disa zgjedhës, pas disa orëve nga votimi kishin treguar se boja e timbrimit ishte e dobët, pasi me larjen e parë të duarve ishte zbehur (p.sh.: në QV nr. 1985 dhe nr. 1981/1, ZAZ nr. 40 në Shkollën 'D.Distria', QV nr. 1936, ZAZ nr. 38 në Shkollën 'S.Çaçi'). Pavarësisht nga kjo, nuk u referua ndonjë informacion që për këtë shkak të jetë votuar më shumë se një herë. Gjithashtu, kishte edhe zgjedhës tek të cilët timbrimi nuk hiqej. Kjo mund të ketë ndodhur si pasojë e cilësisë së ndryshme të bojës së timbrosjes.

3.5. Zgjedhësit me aftësi të kufizuara

Në shumicën e QV të monitoruara në 9 Bashkitë e vendit është konstatuar se nuk ishin marrë masat e nevojshme që parashikon ligji që zgjedhësve me aftësi të kufizuara t'u krijoheshin mundësitë dhe lehtësitë e nevojshme për ushtrimin e të drejtës së votës. Votimi i zgjedhësve me ndihmën e familjarit është konstatuar në 7.4% të QV të monitoruara. Në 16.2% të këtyre rasteve është referuar se nuk është respektuar procedura ligjore e parashikuar në Kodin Zgjedhor për dhënien e ndihmës ndaj zgjedhësve që nuk mund të votojnë vetë. P.sh.: në QV nr. 4460, ZAZ nr. 84 pranë Shkollës 'Lef Sallata' në Vlorë janë konstatuar 2 raste në të cilat personi që ka ndihmuar zgjedhësin nuk ka plotësuar deklaratën respektive në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.⁵⁶

3.6. Mbyllja e QV-ve

Vëzhguesit e KShH-së kanë referuar se në oraret e drekës në QV të monitoruara situata ka qenë shumë e qetë, por pjesëmarrja e zgjedhësve ka qenë e ulët. Kryesisht në intervalin kohor 17.00 – 19.00 është konstatuar një rritje e lehtë e numrit të votuesve që kanë zgjedhur t'i drejtohen QV.

Kodi Zgjedhor parashikon se QV mbyllet pasi ka votuar zgjedhësi i fundit i pranishëm në QV, në orën 19.00. Në përgjithësi, mbyllja e QV-ve është realizuar në orarin e përcaktuar ligjor, por ka pasur edhe disa raste sporadike kur votimi nuk ka përfunduar në këtë orë. P.sh. në QV nr. 3005/3, në Shkollën 'Janaq Kilica' në Fier, procesi i votimit u mbyll në orën

⁵⁵ Në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2017 janë raportuar tentative për votim familjar në 28.8% të QV të monitoruara.

⁵⁶ Neni 108, pika 3, i Kodit Zgjedhor.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

21.00. Ndërsa në QV nr. 1412 dhe nr. 1412/1, në Shkollën ‘Abedin Dino’ në Durrës, procesi u mbyll në orën 19.30. Në Tiranë, në QV nr. 1828/1, në Shkollën ‘Dëshmorët e Lirisë’, vëzhguesi ynë ka referuar, para afatit ligjor të mbylljes së saj, në orën 18.11 po vijojej me numërimin e fletëve të papërdorura nga pakot (vendimi për mbylljen nuk ishte marrë).

Në nenin 112, pika 2 të KZ është parashikuar se pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, në QV mund të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i KQV-së, **si dhe vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe/ose të huaj** dhe përfaqësuesit e akredituar të medias. Në QV nr. 0311, QV nr. 0271 dhe 0271/1 në Shkodër, vëzhguesi i KShH-së nuk është lejuar të vëzhgojë veprimet përmblylëse të procesit të votimit. Vëzhguesi ka referuar bazën ligjore, por ky fakt nuk është marrë parasysh nga komisionerët. Tentativa për të kufizuar aksesin e vëzhguesve ka patur në QV nr. 4501, pranë Shkollës ‘Avni Rustemi’ dhe QV nr. 4471/1, pranë Universitetit ‘I. Qemali’ në Vlorë. Në QV nr. 1867, në Shkollën ‘Musine Kokalari’, pas mbylljes së QV, vëzhguesi i KShH-së ka bërë vërejtje verbale, pasi komisionerët janë ngatërruar nëse duhen numëruar fletët e votimit të papërdorura dhe të dëmtuara.

4. Procesi i numërimit të votave

Afati ligjor për ngritjen e GNV-ve me vendim të KZAZ-vë nuk është respektuar.⁵⁷ Në mbledhjen e datës 22.06.2019, KQZ vendosi shtyrjen e vendimmarrjes për projektvendimin ‘Për ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019’. Për këtë çështje, më dt. 25.06.2019, KQZ vendosi se GNV-të do të përbëhen nga katër anëtarë, dy anëtarë të propozuar nga Partia Socialiste dhe dy anëtarë të përzgjedhur nga KZAZ-ja me short nga komisionerët e emëruar kryesisht në KQV-të (të cilët u zgjedhën nga KZAZ-të sipas vendimmarrjes të KQZ-së të analizuar më sipër dhe bazuar në shortin për listën e emrave të verifikuara/propozuara nga KQZ-ja).⁵⁸

KShH ka monitoruar procesin e numërimit të votave në ambjentet e Vendeve të Numërimit të Votave (VNV), të vendosura pranë 12 ZAZ në 9 bashkitë e mësipërme (13.3% të tyre). Ky monitorim ka zgjatur deri në orën 23:00 të datës 1 Korrik 2019. Vëzhguesit e KShH-së kanë raportuar se vendimet për ndryshimin e disa vendeve të numërimit, edhe pse të nevojshme ka shkaktuar ngatërrësë. Gjatë periudhës kohore 06.06.2019 – 28.06.2019, KQZ ka marrë 10 vendime për ndryshimin e 12 VNV-ve në rang vendi.⁵⁹

4.1. Veprimet paraprake dhe fillimi i numërimit

Shoqërimi i kutive dhe i materialeve të votimit në shumicën dërrmuese të VNV të monitoruara nga KShH është realizuar në përputhje me nenin 114 të KZ.⁶⁰

⁵⁷ Neni 95, pika 1, i Kodit Zgjedhor.

⁵⁸ Vendim nr. 865, dt. 25.06.2019.

⁵⁹ Vendimet e shqyrtuara janë: nr. 803, dt. 06.06.2019; nr. 866, dt. 25.06.2019; nr. 875, dt. 26.06.2019; nr. 881, dt. 27.06.2019; nr. 882, dt. 27.06.2019; nr. 900, dt. 27.06.2019; nr. 904, dt. 27.06.2019; nr. 913, dt. 28.06.2019; nr. 918, dt. 28.06.2019; nr. 923, dt. 28.06.2019. VNV në Qarkun e Elbasanit dhe të Shkodrës, të cilat ishin objekt i monitorimit nga KShH u ndryshuan 2 ditë para datës së zgjedhjeve.

⁶⁰ Në këtë nen është parashikuar se: “1. *Menjëherë pas përfundimit të veprimeve të parashikuara në nenin 113 të këtij Kodi, kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit dërgohen në Vendin e*



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Mgjth, ka patur raste sporadike si transporti i materialeve të votimit të QV nr.4491 drejt ZAZ nr.84, ku rreth orës 20:49, vëzhguesi i KShH-së ka raportuar se shoferi i automjetit të transportit nuk ka lejuar që në makinë të qëndrojë sekretarja, kryetarja e KQV-së dhe polici, me argumentin se në makinën tip furgon nuk kishte vend. Ka patur raste kur Vëzhguesit e KShH-së kanë raportuar për vonesa në përcjelljen e materialeve zgjedhore drejt KZAZ-së. Vonesat janë shkaktuar kryesisht si pasojë e mosardhjes së mjetit të transportit, si dhe për shkak të distancave të largëta të vendndodhjes së QV-ve. P.sh: rreth orës 21:50 është bërë i mundur transporti i kutive të QV nr. 1828 dhe 1828/ drejt, ZAZ nr. 35 pranë Shkollës ‘Dëshmorët e Lirisë’ në qytetin e Tiranës, ndërsa në KZAZ nr. 2 të vendosur pranë Shkollës ‘Arben Broci’ në qytetin e Shkodrës kutitë janë marrë në dorëzim pas orës 00.50. Rreth orës 01:18, anëtarët e KZAZ-ve nr. 3 dhe nr. 4, VNV ‘Shkolla Arben Broci’, pavarësisht marrjes në dorëzim të të gjitha kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, vëzhguesit e KShH-së kanë referuar se vonesa ka ardhur si pasojë e mosngritjes në kohë të GNV-ve për shkak të mungesës së anëtarëve të emëruar kryesisht nga KZAZ-të.

Në KZAZ nr. 21, në VNV ‘Pallati i Sportit Ramazan Njala’ në Durrës, procesi i numërimit të votave ka nisur rreth orës 09.18 të dt. 1 Korrik 2019. Rreth orës 23:59 të dt. 30 Qershor 2019, vëzhguesi i KShH-së në VNV ‘Pallati i Sportit Tamara Nikolla’ në Korçë ka vërejtur mungesë të anëtarëve të GNV-ve, situatë që ka krijuar vonesë në fillimin e procesit të numërimit. Vëzhguesit e KShH-së kanë referuar përbërjen e GNV-ve vetëm nga 2 anëtarë, përkatësisht një grup në KZAZ nr. 39 të vendosur pranë Muzeut Kombëtar në Tiranë dhe 4 GNV në KZAZ nr. 3 në Shkollën ‘Arben Broci’ në Shkodër, çka bie ndesh me nenin 95, pika 2 e KZ. Këto problematika kanë ndikuar në mbarëvajtjen e procesit të numërimit dhe në cilësinë e trajnimit të GNV-ve. Vëzhguesit kanë raportuar se trajnimi i GNV-ve ka zgjatur në një hark kohor relativisht të shkurtër, prej 15⁶¹ – 45 min⁶².

Mbajtja e procesverbalit pas marrjes në dorëzim të kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore, mungesa e kontestimeve apo e parregullsive gjatë procesit të dorëzimit të tyre, si dhe marrja e vendimeve nga KZAZ-të për nisjen e procesit të numërimit të votave tregojnë për respektimin në tërësi të procedurave në hapjen e procesit të numërimit. Në ndonjë rast

Numërimit të Votave, të caktuar sipas nenit 94 të këtij Kodi. Materialet e tjera të përdorura gjatë procesit të votimit i dorëzohen KZAZ-së brenda afateve dhe në mënyrën e përcaktuar nga KQZ-ja. 2. Kutia/kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit dorëzohen në Vendin e Numërimit të Votave sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 3 orë nga mbyllja e votimit në qendrën e votimit. Dërgimi i tyre bëhet me automjet, në të cilin ndodhen anëtarët dhe sekretari i KQV-së, si dhe një punonjës policie, i cili ka detyrë të garantojë shoqërimin dhe mosprekjen e kutisë/kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë së materialeve të votimit. KQZ-ja autorizon KZAZ-në, duke i dhënë edhe fondet e nevojshme financiare, për të siguruar transportimin me automjet të kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutinë me materialet e votimit. 3. Punonjësi i policisë, sipas pikës 2 të këtij neni, është efektiv i përhershëm i Policisë së Shtetit, përjashtuar policinë kriminale, i ngarkuar me detyrën e shoqërimit nga KQZ-ja, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Polici i shoqërimit 138 duhet në çdo moment të mbajë uniformën e Policisë së Shtetit dhe të ketë në një vend të dukshëm numrin rendor të caktuar nga KQZja dhe mbiemrin e tij me përmasa të dukshme”.

⁶¹ GNV pranë KZAZ nr. 30, Palestra e Shkollës ‘1 Maji’ në qytetin e Tiranës.



⁶² GNV pranë KZAZ nr. 47, 49 dhe 50, pranë Pallatit të Sportit ‘Tomorr Sinani’ në qytetin e Elbasanit.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

sporadik, vëzhguesi i KShH-së ka vënë në dijeni anëtarët e KZAZ nr. 50, se tabela e rezultateve për kryetar të Bashkisë Elbasan për QV nr. 2335/1, është nënshkruar vetëm nga sekretari i GNV nr. 02.⁶³ Pas ndërhyrjes së vëzhguesit, është shmangur kjo parregullsi.



4.2. Aksesit i vëzhguesve të KShH-së gjatë numërimit

Për monitorimin e procesit të numërimit, KShH ka angazhuar 24 vëzhgues, të cilët përgjithësisht nuk janë penguar për të hyrë apo për të qëndruar në ambientet e numërimit. Përrjashtimisht, kufizime të aksesit të vëzhguesve të KShH-së ka patur në KZAZ nr. 5 në qytetin e Shkodrës⁶⁴, apo në ambientet e KZAZ-së nr. 34, VNV Shkollës 'Vasil Shanto' dhe KZAZ-së nr. 39, VNV 'Holli i Muzeut Kombëtar', ku vëzhguesit nuk janë lejuar të aksesojnë ambientet deri rreth orës 00.00 me argumentin se nuk janë marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit dhe ambienti i VNV-së është rrëmujë.

4.3. Respektimi i procedurave ligjore gjatë numërimit



Transparenca në procesin e numërimit të votave nuk është garantuar në mënyrë të plotë. Rreth orës 13.01, vëzhguesi i KShH-së i cili po monitoronte procesin në KZAZ nr. 35, në Shkollën 'Vasil Shanto' ka referuar vërejtje verbale, pasi njëri prej ekraneve të monitorëve nuk aksesohet lehtësisht për shkak të problemeve të dritës. Problematika me ndriçimin janë konstatuar në këtë ambient në mënyrë të vazhdueshme, pasi palestra e ka tavanin me pjesë xhami dhe dielli interferon në kamera. Anëtarët e KZAZ-së janë përpjekur të rregullojnë situatën, nëpërmjet improvizimit të

⁶³ Neni 119, pika 1, i Kodit Zgjedhor.

⁶⁴ Për kufizimin e aksesit të vëzhguesit të akredituar nga ana e Znj. Ermira Ymeraj, është vënë në dijeni në rrugë elektronike KQZ.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

strehave të kartonit. Vëzhguesi i KShH-së në KZAZ nr. 39, pranë Shkollës së Kuqe ka referuar vërejtje verbale ndaj GNV për shkak se fletët janë kaluar në mënyrë të shpejtë në monitor.

Pavarësisht numrit më të ulët të votuesve në këto zgjedhje, sërisht ka patur ndërprerje të përkohshme apo pezullim të procesit të numërimit në disa VNV, si pasojë e lodhjes së anëtarëve të GNV-së të cilët kanë qenë të përfshirë si komisionerë të QV-ve, gjatë pjesës së parë të ditës⁶⁵, por edhe si pasojë e problematikave të përsëritura me sistemin elektronik⁶⁶. Vëzhguesit e KShH-së kanë raportuar se procesi i numërimit nga GNV-të është realizuar përgjithësisht me ritme të ngadalta gjatë periudhës që kemi kryer monitorimin. Gjithashtu, sipas vëzhguesve të KShH-së, ka patur vonesa të pajustificuara nga GNV-të dhe KZAZ-të për të filluar numërimin e fletëve të para të votimit në orën 13:12 të dt. 1 Korrik 2019, në KZAZ nr. 84, pranë Pallatit të Sportit në qytetin e Vlorës.

Në qendrat e numërimit të votave të vëzhguara nga KShH, një numër i konsiderueshëm i fletëve të votimit u konsideruan të pavlefshme.

4.4. Atmosfera brenda ambienteve të numërimit



Në përgjithësi, klima brenda ambienteve të numërimit të monitoruara ka qenë e qetë dhe nuk është shoqëruar me incidente. Kontestimet ose pasaktësitë ishin të pakta. Për këto vendoste sipas rastit KZAZ-ja. Prezencë e personave të paautorizuar në ambientet e numërimit është raportuar nga ana e vëzhguesit në KZAZ nr. 30, në Palestrën e Shkollës ‘1 Maji’ në qytetin e Tiranës. Vëzhguesi i KShH-së na ka vënë në dijeni se nga ana e komisioneres së KZAZ-së janë vënë në dijeni forcat e rendit, por nga këto të fundit nuk është ndërmarrë asnjë veprim. Nga pamjet filmike të vëna në dispozicion nga ana e vëzhguesit konstatohet se sjellja e personit të paautorizuar është e një natyre intimiduese mbi anëtarët e GNV-ve. Ky shtetas është raportuar se ka dalë jashtë nga

VNV-ja, pas ardhjes së mediave për të filmuar. Në këtë rast nuk raportohet të jetë mbajtur shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së përkatëse. Gjatë pjesës së parë të ditës së dt. 1 Korrik 2019, vëzhguesi i KShH-së në KZAZ nr. 35 pranë Shkollës ‘Vasil Shanto’ ka raportuar temperatura të larta, situatë që ka vështirësuar mbarëvajtjen e procesit të numërimit.

Për shkak të numrit të paktë të vëzhguesve nuk është mundur që procesi i numërimit të votave të ndiqej në të gjitha qendrat e numërimit. KShH ishte në pamundësi të ndiqte deri në fund rezultatin e pasqyruar në tabelat përmbledhëse të përgatitura nga KZAZ-të e monitoruara.

⁶⁵ VNV ‘Janaq Kilica’, KZAZ nr. 58 në qytetin e Fierit.

⁶⁶ VNV ‘Janaq Kilica’, KZAZ nr. 58 në qytetin e Fierit dhe VNV ‘Pallati i Sportit Tamara Nikolla’, KZAZ nr. 72 në qytetin e Korçës etj.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

5. Rekomandime

Edhe pse OSBE/ODIHR-i nuk ka publikuar ende raportin e tij përfundimtar lidhur me zgjedhjet e 30 qershorit 2019, në këtë pjesë të raportit të monitorimit të KShH-së, gjejmë rastin të parashtrijmë disa rekomandime, të cilat mund të shërbejnë në drejtim të përmirësimit të legjislacionit dhe zbatimit të tij, për të garantuar zgjedhje të lira dhe të ndershme. Praktika ka vërtetuar se është e nevojshme mbështetja në rregulla dhe legjislacion të plotë, të saktë dhe të qartë.

6.1 KShH çmon se është e domosdoshme dhe urgjente që të arrihet dialogu midis partive më të mëdha në vend, që i përkasin mazhorancës dhe opozitës, pasi pa vullnet politik dhe në mungesë të konsensusit konstruktiv nuk mund të kapërcehen kundërshtitë dhe atmosfera e tensionuar politike.

6.2 Edhe këto zgjedhje vërtetuan domosdoshmërinë e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, duke vërtetuar disa mangësi, paqartësi dhe shkelje të legjislacionit zgjedhor. Këto mund të parandaloheshin nëse në Kodin Zgjedhor do të ishin bërë ndryshimet përkatëse, në zbatim të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. KShH mendon gjithashtu se në këtë drejtim ka ndikuar negativisht edhe mos pjesëmarrja si subjekt zgjedhor e dy partive më të mëdha opozitare, PD dhe LSI pasi gara zgjedhore është element i kontrollit reciprok.

6.3 KShH vlerëson se reforma zgjedhore kërkon konsensus dhe dialog të gjerë politik, transparencë dhe gjithëpërfshirje. Është e nevojshme të merren në shqyrtim rekomandimet e OSBE/ODIHR-it të pasqyruara në raportet e katër proceseve zgjedhore të fundit, përfshi edhe të dt.30 Qershor 2019. Rekomandim kyç është ai për depolitizimin e administratës zgjedhore në të gjitha nivelet, i cili edhe në këto zgjedhje nuk u përmbush.

6.4 Ndryshimet në Kodin Zgjedhor nuk duhet të jenë monopol i partive politike. Në këtë vështrim mendojmë se duhet të shmanget konsultimi formal dhe të dëgjohet efektivisht mendimi i grupeve të interesit, ekspertëve, si dhe organizatave dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

6.5 Lidhur me sistemin zgjedhor, mendojmë se kjo çështje kërkon një analizë të thelluar, objektive dhe të gjithanshme. Rishikimi i sistemit zgjedhor kërkon paralelisht një reformë ligjore në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të partive politike. Pavarësisht se çdo sistem ka avantazhet dhe disavantazhet e tij, në mënyrë të veçantë për këtë çështje duhet të ketë konsultime dhe dëgjesa publike me qytetarët që janë aktiv në jetën publike.

6.6 Pjesëmarrja e votuesve në Zgjedhjet Vendore të datës 30 Qershor 2019 mori vëmendjen më të madhe. Është e nevojshme që në këtë drejtim rëndësi e veçantë t'i jepet transparencës ndaj publikut, të kriterëve që ndjekin partitë politike për të propozuar tek elektorati kandidaturat përkatëse. Po kaq të rëndësishme janë platformat e kandidatëve, të cilat duhet të ofrojnë alternative zgjidhje për problemet me të cilat ndeshen qytetarët. Për kandidatët që deklarohen fitues, platformat e parashtruara nuk duhet të ngelen thjesht në



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

letër, por të ndërmerren përpjekje serioze dhe të ketë angazhim maksimal për realizimin e objektivave të tyre. Në të kundërt besimi i zgjedhësve tek partitë politike do të jetë i ulët dhe kjo do të reflektojë në pjesëmarrjen e ulët të tyre në instrumentin e demokracisë direkte, me anë të të cilit çdo zgjedhës legjitim ushtron të drejtën themelore të votës.

6.7 KShH vëren se vlejnjë të rishikohen dispozitat e Kodit Zgjedhor për kandidaturat që propozohen nga subjektet zgjedhore për kryetar bashkie, pasi këto dispozita, në ndryshim nga dispozitat për kandidaturat për anëtar të Këshillit Bashkiak, nuk parashikojnë kuota gjinore për përfaqësimin e gjinisë femër. Kjo ndikoi edhe në përfaqësimin e ulët të femrave gjatë garimit për kryetar bashkie dhe në kandidaturat që u shpallën fituese nga KQZ.

6.8 KShH mendon se roli i KQZ-së duhet të jetë më proaktiv, jo vetëm ditën e votimit dhe të numërimit të votave, por edhe gjatë gjithë periudhës së procesit parazgjedhor. Ndërhyrjet e tij për vënien në vend të ligjit të cënuar duhet të jenë të menjëhershme dhe të ndjeshme, me qëllim që ato të kenë efekte parandaluese. Për KQZ-në transparenca dhe informimi i publikut për çështje që i interesojnë atij, duhet të vlerësohen si detyrim parësor.

6.9 KQZ-ja kur është rasti nuk duhet të hezitohet për marrjen e masave të parashikuara nga nenet 171 (sanksione administrative), neni 172 (sanksione për shkeljen e parimeve të Kodit), neni 173 (sanksione në lidhje me financimin e fushatës), neni 174 (thyerja e heshtjes zgjedhore) dhe neni 175 (sanksione në lidhje me barazinë gjinore).

6.10 Duke patur parasysh se njohuritë profesionale të anëtarëve të komisioneve zgjedhore luajnë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, si dhe faktin se thuajse në të gjitha zgjedhjet janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore të Kodit Zgjedhor si pasojë e mos njohjes së tij, KShH mendon se duhet që ky problem të analizohet seriozisht dhe të përcaktohen format dhe mënyrat, si dhe koha e mjaftueshme për një trajtim cilësor dhe efektiv.

6.11 Përsa i përket fenomenit të vjedhjes së votës, KShH mendon se ky është një problem që është evidentuar në çdo proces zgjedhor. Mendimi se në këtë drejtim duhen ashpërsuar masat e dënimit penal, edhe pse ato mund të kenë ndonjë efekt pozitiv dhe parandalues, nuk e zgjidh problemin. Kryesore është ndërgjegjësimi i vetë subjekteve zgjedhore, sidomos i partive politike të mëdha, që jo vetëm të mos pajtohen me veprime të tilla, por të dënojnë dhe t'i denoncojnë ato. Del nevoja që në rastet e kryerjes së veprave penale në fushën e zgjedhjeve, hetimi dhe gjykimi i tyre objektiv dhe jo selektiv, i gjithëanshëm, me përparësi dhe brenda një afati sa më të arsyeshëm. Deri tani, ndëshkueshmëria e këtij fenomeni ka qenë e papërfillshme.